



OJQ LËVIZJA FOL ("FOL")

PASQYRAT FINANCIARE ME RAPORT TË AUDITORËVE TË PAVARUR

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

Përmbajtja

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR.....	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E BILANCIT TË FONDEVE	7
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	8
1. Informata të Organizatës.....	9
2. Baza e përgatitjes	10
3. Përmbledhja e politikës së rëndësishme në kontabilitet	11
4. Paraja në bankë dhe dorë.....	12
5. Llogaria e arkëtueshme	12
6. Të hyrat e shtyra	12
7. Llogaritë e pagueshme	13
8. Shpenzimet administrative dhe programore	13
9. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese.....	13



NOVAZA L.L.C.
Str. Fehmi Agani 42/1
10000 Prishtinë, Kosovë

t: +383 (0)44-993-337
w: www.novaza-ks.com
e: info@novaza-ks.com

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për: Menaxhmentin e LËVIZJA FOL ("FOL")

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të LËVIZJA FOL ("FOL") (Organizata), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2024 dhe pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Organizatës për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2024 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kërkesat për raportim financiar të përshkruar në shënimin 2 dhe kërkesave sipas ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbyshur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përftuara të auditimit janë të majftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimi, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përftuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijoje aktivitetet e saj.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Altin Sahiti
Auditor Ligjor

Prishtinë, Kosovë
25 mars 2025



LËVIZJA FOL**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

Me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

Me 31 dhjetor*Shënimet***2024****2023****Pasuria joqarkulluese**

Pajisjet

Gjithsej**Pasuria qarkulluese**

Paraja në bankë dhe dorë

4

101,261

143,735

Llogaria e arkëtueshme

68

-

Gjithsej**101,329****143,735****Gjithsej pasuria****101,329****143,735****Detyrimet**

Të hyrat e shtyra

5

94,680

133,727

Të pagueshmet

6

6,649

10,008

Gjithsej**101,329****143,735****Balanci i fondeve**

Saldo fillestare

Teprica/(humbja) e periudhës

Gjithsej

-

Gjithsej detyrimet dhe fondet**101,329****143,735**

Aprovuar nga Bordi dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Mexhide Demolli-Nimani – Drejtoreshë Ekzekutive**Granit Zhubi** – Menaxher i Financave*Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 15 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.*

LËVIZJA FOL

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		2024	2023
	<i>Shënimet</i>		
Grantet dhe donacionet	5	345,683	272,383
Gjithsej		345,683	272,383
Shpenzimet programore	7	(345,683)	(272,383)
Gjithsej shpenzime		(345,683)	(272,383)
Teprica (humbja)		-	-

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 15 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

LËVIZJA FOL

PASQYRA E BILANCIT TË FONDEVE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

	Bilanci i fondeve	Total
Gjendja me 31 dhjetor 2022	-	-
Teprica (deficiti) I periudhës	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2023	-	-
Teprica (deficiti) I periudhës	-	-
Gjendja me 31 dhjetor 2024	-	-

LËVIZJA FOL

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor

Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative

Teprica (humbja) neto e vitit

Ndryshimet në pasuri dhe detyrime

Zhvlerësimi

Rritje tek Llogaria e arkëtueshme

Zvogëlim tek Llogaria e pagueshme

Zvogëlim tek Të hyrat e shtyra

Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative

Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese

Investimet në paisje

Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese

Ndryshimi neto i rrjedhës së parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit

Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit

	2024	2023
	-	-
	(68)	-
	(3,359)	7,967
	(39,047)	53,657
	(42,474)	61,624
		-
		-
	(42,474)	61,624
	143,735	82,111
	101,261	143,735

Shënimet shoqëruese nga 1 deri në 15 të pasqyrave financiare janë pjesë integrale e tyre.

LËVIZJA FOL

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

1. Informata të Organizatës

Lëvizja FOL është e regjistruar si organizatë joqeveritare sipas ligjit nr.06/L43 "Për lirinë e organizimit në institucionet joqeveritare" me nr. Regjistrimi 5112424-3 te dates 25.06.2009 dhe nr fiskal 600186862.

Që nga themelimi i saj në vitin 2008, Lëvizja FOL ka promovuar në mënyrë aktive shqyrtimin publik të punës së qeverisë si themeli më i sigurt për një shoqëri demokratike dhe të hapur me institucione publike të përgjegjshme dhe transparente.

Pas shpalljes së pavarësisë nga Kosova në vitin 2008, ishte e qartë se vendi i ri kërkonte një shoqëri civile të gjallë për të siguruar që institucionet publike të funksionojnë në përputhje me normat dhe standardet demokratike, dhe lehtësimi i qytetarisë aktive ishte çelësi për këtë.

Vizioni i FOL-it është që Kosova të jetë një vend në të cilin qytetaria aktive që mban përgjegjësinë e qeverisë të lulëzojë dhe institucionet publike të funksionojnë pa korrupsion, duke respektuar normat e një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Që nga viti 2008, shtylla e qasjes strategjike të FOL ka qenë fokusi tek të rinjtë dhe komunitetet e marginalizuara, duke u dhënë atyre mjetet dhe njohuritë e nevojshme për të kërkuar dhe arritur llogaridhënie nga qeveria. Pavarësisht përpjekjeve dhe punës së palodhur, arritja e qëndrueshmërisë demokratike mbetet një sfidë.

FOL fokuson punën e saj në shpenzimet publike, luftimin e formave të ndryshme të korrupsionit dhe neglizhencës institucionale, si dhe promovimin e llogaridhënies. Nëpërmjet hulumtimit të politikave, avokimit, mbështetjes teknike dhe institucionale, monitorimit të institucioneve publike, konferencave, seminareve, tryezave të rrumbullakëta dhe formave të tjera të mobilizimit dhe rrjetëzimit, si dhe programeve të trajnimit të debatit dhe debatit, FOL rrit presionin publik mbi vendimmarrësit për të reduktuar abuzimin e pushteti publik. Përveç forcimit të transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve vendimmarrëse dhe zyrtarëve publikë, FOL punon për të hapur kanale të reja komunikimi midis qeverisë dhe qytetarëve dhe për të reduktuar apatinë qytetare. Në vitin 2012, FOL ka inicuar procesin e anëtarësimit të Kosovës në Partneritetin për Qeverisje të Hapur – OGP. Në bazë të kërkesës së FOL-it, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim zyrtar për fillimin e procedurave për anëtarësim në këtë organizatë.

Lëvizja FOL me mbështetjen e Ministrisë së Integritetit Evropian dhe Grupit Koordinues ka hartuar Planin Kombëtar të Veprimit 2014-2016 me gjithsej 29 veprime dhe 41 nënveprime. Planin Kombëtar i Veprimit 2014-2016 është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 29 prill 2014. Për më tepër, në janar 2014, FOL është bërë anëtare e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit – Koalicioni UNCAC. Ndërsa në prill të vitit 2014, FOL është zgjedhur anëtare e Komitetit Koordinues për Rajonin Evropian në Koalicionin UNCAC. UNCAC është një rrjet global i organizatave të shoqërisë civile që angazhohet dhe promovon luftën kundër korrupsionit përmes avokimit për ratifikimin, zbatimin dhe monitorimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit – UNCAC. Ky koalicion është themeluar në vitin 2006, përmes mobilizimit të organizatave të shoqërisë civile të UNCAC në nivel ndërkombëtar, kombëtar dhe rajonal. Lëvizja FOL është gjithashtu anëtare e Rrjetit kombëtar të OJQ-ve Demokracia në Veprim që merret me monitorimin e zgjedhjeve në Kosovë. Gjithashtu FOL është anëtar i Komitetit Kombëtar për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe organizatave të shoqërisë civile që nga shtatori 2014.

LËVIZJA FOL

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

1. Informata të organizatës (Vazhdim)

Lëvizja FOL ka përfshirë elemente të angazhimit qytetar në aktivitetet e saj në të gjitha projektet. Për shembull, si pjesë e punës së rregullt të monitorimit të gjyqësorit nga FOL, janë organizuar takime ndërmjet grupeve të ndryshme të qytetarëve dhe krerëve të gjyqësorit të Kosovës, duke krijuar një mjedis për komunikim të drejtpërdrejtë, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies. Anëtarët e Lëvizjes FOL, çdo vit e njohin guximin e qytetarëve dhe gazetarëve aktivë për punën e tyre për të kërkuar llogari nga pushteti. Guximi Qytetar jepet që nga viti 2009, ku fituesja e parë ishte një grua, e cila sfidoi kërcënimet fizike kundër sigurisë së saj dhe vazhdoi të punojë për të mbrojtur të drejtat e grave. Në kuadër të forumit FOL Hapur (Speak Up), Lëvizja FOL ka udhëtuar në të gjitha komunat e Kosovës për të angazhuar qytetarët dhe për të lehtësuar komunikimin mes qytetarëve dhe institucioneve publike. Dëshmi e përkushtimit të fortë të Lëvizjes FOL me qytetarët është fakti se organizata çdo ditë pranon qytetarët që vijnë për të ngritur ankesat dhe problemet e tyre lidhur me mungesën e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike.

Plani i ri strategjik nuk është përvojë e re për Lëvizjen FOL, por forcon fokusin e organizatës në nivel komunal. Ajo që është e re është se organizata po kërkon të zhvillojë metoda të reja se si të angazhojë më shumë qytetarë përmes platformave dixhitale.

2. Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 06/L-043 Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Jo-qeveritare me qëllim të raportimit në Zyrën e Rregullatorit të OJQ-ve.

Të hyrat nga grantet njihen kur fitohen në vend se kur pranohen dhe shpenzimet njihen kur ndodhin në vend se kur paguhen.

Perveç kësaj, detyrimi i shtyrë i grantit, parapagimet dhe detyrimet e tjera regjistrohen sipas bazës akruale të kontabilitetit. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit janë përshkruar më poshtë.

LËVIZJA FOL

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

3. Përmbledhja e politikës së rëndësishme në kontabilitet

3.1. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paranë në arkë dhe paranë e pakushtëzuar me bankat ose depozitat me afat maturimi më pak se tre muaj.

3.2. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose për t'u arkëtuar dhe përfaqëson vetëm shumën e arkëtueshme nga donatorët në lidhje me listën e pagave, shpenzimet operative dhe shpenzimet tjera të shkaktuara.

3.3. Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të ndryshme nga valuta funksionale (valutë të huaj) regjistrohen në normat e këmbimit që mbizotërojnë në datat e transaksioneve. Në çdo datë raportimi, zërat monetare të shprehur në valutë të huaj konvertohen në normat mbizotëruese në datën e raportimit. Zërat jo-monetarë që maten me kosto historike në valutë të huaj nuk ripërkthehen. Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga zërat monetare, janë të përfshira në fitimin dhe humbjen e periudhës në të cilën ato lindin.

3.4. Përfitimet e punonjësve

Organizata nuk ka përgjegjësi shtesë për pensionet e punëtorëve përveç pagesës së kontributeve pensionale në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

3.5. Kontigjencat dhe provizionet

Detyrimet kontigjente nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përveç nëse mundësia e rrjedhës se mjeteve që trupezojnë përfitime ekonomike është e largët. Një pasuri kontigjente nuk njihet në pasqyrat financiare por shpaloset kur hyrja e përfitimeve ekonomike është e mundshme. Një provizion është i njohur atëherë kur Organizata ka një detyrim të pranishëm (ligjor ose strukturor) si rezultat i një ngjarje të kaluar dhe është e mundshme që një rrjedhje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohen për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund t'i bëhet shumës së detyrimit.

3.6. Gjykime kritike kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim

Në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Organizatës, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka herë asnjë gjykim i cili ka efekte të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare

LËVIZJA FOL**SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

*(Të gjitha shumat në Euro)***4. Paraja në bankë dhe dorë**

Me 31 dhjetor	2024	2023
Paraja në bankë	100,525	143,587
Paraja në dorë	736	148
Total	101,261	143,735

5. Llogaria e arkëtueshme

Me 31 Dhjetor	2024	2023
FIT EU	68	
Total	68	-

6. Të hyrat e shtyra

Donatori	Të hyrat e shtyra nga 2023	Transferuar në 2024	Shpenzimet 2024	Të hyrat e shtyra për periudhën tjetër
CDF-2024	-	45,000	44,355	645
German Embassy 2024	-	16,650	16,129	521
Rockefeller Brothers Fund 2024	-	35,818	10,716	25,102
Rockefeller Brothers Fund 2022	33,831		33,831	-
Open Contracting	58			58
FES - Elections 2021	30			30
KAS Prishtina	2,876			2,876
CSD - LEGA PROJECT	691			691
Debate Center - 2019	3,628			3,628
ATRC	200			200
Monitorimi i konsultimeve publike	27			27
D4D-NDI	93	723	1,230	(415)
World Bank BGF	5,964	37,337	37,335	5,966
Smart Balkans 2023	(2,373)	8,033	6,820	(1,160)
Internews	7,669			7,669
Balkan Tender Watch	12,606	6,566	19,172	-
ROYAL NETHERLANDS EMBASSY - MATRA	2,412		7,382	(4,969)
TEAM DAI - Whistleblowing 2023	1,917	24,752	9,291	17,378
EU-EIDHR	15,299	50,852	50,991	15,160
Predstavnistvo World Learning	100			100
Karadjordje				
Sbunker	730		730	-
KMI - Enhancing Procurement Practices 2024			1,620	(1,620)
Open Procurement Transparency Portal	15,700	-	-	15,700
PERFORMANCE 2018	(193)			(193)
IFES 2023	40,347		11,236	29,111
US EMBASSY	(7,884)	80,905	94,844	(21,824)
Total	133,727	306,636	345,683	94,680

LËVIZJA FOL

SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024

(Të gjitha shumat në Euro)

7. Llogaritë e pagueshme

Me 31 dhjetor	2024	2023
Llogari tjera të pagueshme	482	5,376
Tatimi dhe Kontributet për Paga (Dhjetor)	6,167	4,632
Total	6,649	10,008

8. Shpenzimet administrative dhe programore

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2024	2023
Personeli	117,210	101,377
konsulentët	82,740	20,811
Udhëtim, Transport, Mëditje	8,979	40,124
Objektet dhe Pajisjet	5,682	5,295
Furnizimet	333	4,201
Kostot e tjera direkte	81,860	15,024
Operacionet	28,701	80,775
Grantet	20,178	4,775
Total	345,683	272,383

9. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese

Nuk ka ngjarje që pasojnë datën e raportimit që kërkojnë dhënie të informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare të Organizatës.